



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-SC-2024-02

**Vendosi:** Paneli i Dhomës së Gjykatës Supreme  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse  
Gjykatëse Kristinë van den Vajngart  
Gjykatës Daniel Fransen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 15 mars 2024

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

## Urdhër mbi Afatet e Parashtrimeve

---

**Prokurores së Specializuar:**

Kimberli P. Uest

**Mbrojtjes së Salih Mustafës:**

Julius von Bone

**Mbrojtjes së Viktimave:**

Ani Pues

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SUPREME** i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Paneli i Gjykatës Supreme” ose “Paneli”), në bazë të nenit 48(6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuar dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 9(5)(a) dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses I shqiptoi Aktgjykimin, me të cilin, ndër të tjera, e shpalli z. Salih Mustafa fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe e shpalli të pafajshëm për krimin e luftës të trajtimit mizor.<sup>1</sup> Trupi Gjykses e dënoi z. Mustafa me 26 vjet burgim.<sup>2</sup>
2. Më 6 prill 2023, Trupi Gjykses I lëshoi Versionin e Korrigjuar të Versionit të Redaktuar Publik të Urdhrit për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës me 4 Shtojca Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*, me të cilin e urdhëroi z. Mustafa t’u paguante 207.000 euro viktimave të krimeve për të cilat u shpall fajtor si kompensim për dëmin e shkaktuar.<sup>3</sup>
3. Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi Versionin e Redaktuar Publik të Aktgjykimit të Apelit, me të cilin la në fuqi verdiktet e fajësisë së z. Mustafa për krimet e luftës së ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, por miratoi, pjesërisht, apelin e z. Mustafa kundër dënimit të tij.<sup>4</sup> Për këtë qëllim, Paneli i Gjykatës së Apelit e uli dënimin e z. Mustafa në 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.<sup>5</sup>
4. Më 17 janar 2024, Kryetarja caktoi Panelin e Gjykatës Supreme për shqyrtimin, ndër të tjera, të çdo kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë që do të dorëzohej nga z. Salih Mustafa.<sup>6</sup>

5. Më 14 mars 2024, z. Mustafa dorëzoi Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcat 1 dhe 2 konfidenciale sipas nenit 48 (6) to (8) të Ligjit dhe Rregullës 193 të Rregullores ("Kërkesa").<sup>7</sup>

## II. DISKUTIM

6. Sikurse është përmendur më parë,<sup>8</sup> përveç dispozitës së përgjithshme mbi afatet e përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores, Rregullorja nuk përcakton afate konkrete brenda të cilave palët duhet të dorëzojnë përgjigje dhe kundërpërgjigje ndaj kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë në përputhje me nenin 48(6) të Ligjit. Duke pasur parasysh llojin dhe kuadrin e Kërkesës, Paneli gjykon se është në interes të drejtësisë të ndryshojë afatet për dorëzimin e përgjigjeve dhe kundërpërgjigjeve ndaj Kërkesës, në qoftë se do të ketë, konkretisht, si më poshtë.

## III. VENDIM

7. Bazuar në sa më lart, Paneli **URDHËRON**

- a) Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dhe mbrojtësen e viktimave të dorëzojnë përgjigjet e tyre përkatëse ndaj Kërkesës, në qoftë se do të kenë, deri më 15 prill 2024; dhe
- b) Z. Mustafa të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij ndaj përgjigjeve të ZPS-së dhe

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05/F00494, Aktgjykim, 16 dhjetor 2022 (konfidencial), para. 831. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 24 janar 2023 dhe versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 qershor 2023.

<sup>2</sup> Aktgjykim, para. 831.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-05/F00517/RED/COR, Version i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Urdhrit për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës me 4 Shtojca Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 6 prill 2023, para. 283.

<sup>4</sup> KSC-CA-2023-02/F00038/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit, 14 dhjetor 2023, para. 484.

<sup>5</sup> Aktgjykim i Apelit, para. 484.

<sup>6</sup> F00003, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës Supreme, 17 janar 2024.

<sup>7</sup> F00011, Kërkesë e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcat Konfidenciale 1 dhe 2 në bazë të Nenit 48 (6) deri (8) të Ligjit dhe Rregullës 193 të Rregullores, 14 mars 2024.

<sup>8</sup> KSC-SC-2023-01/F00004, Urdhër mbi Afatet e Parashtrimeve, 4 maj 2023, para. 3.

mbrojtëses së viktimave, në qoftë se do të ketë, brenda 21 ditësh nga njoftimi i përgjigjeve.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,**  
**Kryegjykatëse**

E premte, 15 mars 2024  
Në Hagë,  
Holandë